

“BËHU INOVUES” - garë për Plan Biznesi

Gara është e destinuar për të rinjtë, persona me ide inovuese, të moshës deri më 35 vjeç, të cilët dëshirojnë të fillojnë biznesin e tyre. Gara është e hapur për ide të gjithëllojshme (shërbime dhe prodhim) nga çdo degë e ekonomisë.

Kandidatët e paraqitur nuk janë të obliguar të ndjekin trajnimet, për të marrë të drejtën e aplikimit në këtë garë. Por, sugjerohet që kandidatët e interesuar të ndjekin trajnimet, për të fituar më tepër njohuri rrethë biznes planeve të tyre.

- **Paraqitja e ideve për plane biznesi me ide inovuese (www.ncdiel.mk)**

Idetë tuaj për plan biznesi inovues duhet t’i jepni online nëpërmjet ueb-portalit www.ncdiel.mk të Qendrës Kombëtare për Zhvillim të Inovacioneve dhe Mësimi Sipërmarrës.

Fondin shpërblyes prej 21.000 eurosh, i siguar nga Agjencia Austriake Zhvillimore për Bashkëpunim në Maqedoni, do ta ndajnë 10 sipërmarrësit e ardhshëm me plane të biznesit me ide më inovuese.

Për informacione shtesë, drejtohuni në Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë – QeSHK.

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM: 15 SHKURT 2010